



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 92**

**11 mars**

**2014**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Konventa evropiane “Për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues”, miratuar me ligjin nr. 8135, datë 31.7.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20/96, faqe 723.....	3
Konventa evropiane “Për ekstradimin” dhe dy protokollet shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10/98, faqe 353.....	6

**KONVENTA EVROPIANE PËR PARANDALIMIN  
E TORTURËS E TË DËNIMEVE OSE TË  
TRAJTIMEVE ÇNJERËZORE DHE  
DEGRADUESE**

*Strasbourg, 26 nëntor 1987*

Hyrë në fuqi: 1 shkurt 1989, sipas dispozitave të nenit 18.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të kësaj Konvente,

*Duke pasur parasysh* dispozitat e Konventës për Ruajtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore;

*Duke kujtuar* se sipas nenit 3 të së njëjtës Konventë “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerezore dhe degraduese”;

*Duke vërejtur* se personat që pretendojnë se janë viktimat të shkeljeve të nenit 3 mund t’i drejtohen mekanizmit të parashikuar nga kjo Konventë;

*Të bindur* se personat e privuar nga liria mund të mbrohen më mirë kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerezore ose poshtëruese me anë të një mekanizmi jogjyqësor, me karakter parandalues, të bazuar në vizitat që mund t’u bëhen këtyre personave,

janë marrë vesh për sa vijon:

## KAPITULLI I

### Neni 1

Të formohet një komitet evropian për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerezore ose degraduese (i quajtur më tej “Komiteti”). Me anë të vizitave që u bëjnë, Komiteti shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria, me qëllim që të përforcojë në rast se është e nevojshme, mbrojtjen e tyre kundër torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerezore ose degraduese.

### Neni 2

Në përputhje me këtë Konventë, çdo Palë duhet të lejojë vizita në çdo vend, nën juridiksionin e saj, ku gjenden persona të privuar nga liria me vendim të një autoriteti publik.

### Neni 3

Komiteti dhe autoritetet kombëtare kompetente të Palës përkatëse do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për zbatimin e kësaj Konvente.

## KAPITULLI II

### Neni 4

1. Komiteti përbëhet nga një numër anëtarësh i barabartë me atë të Palëve.

2. Anëtarët e Komitetit zgjidhen ndërmjet personaliteteve me moral të lartë, të njohur për

kompetencën e tyre në fushën e të drejtave të njeriut ose që kanë një eksperiencë profesionale në fushat për të cilat bën fjalë kjo Konventë.

3. Komiteti nuk mund të ketë më shumë se një shtetas të të njëjtit shtet.

4. Anëtarët marrin pjesë individualisht, janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e mandateve të tyre dhe janë të gatshëm për të përmbushur funksionet e tyre në mënyrë efektive.

### Neni 5

1. Anëtarët e Komitetit zgjidhen nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës me shumicë absolute votash, nga një listë emrash që hartohet nga Byroja e Asamblesë Konsultative e Këshillit të Evropës; delegacioni kombëtar i çdo Pale në Asamblenë Konsultative paraqet tre kandidatë, nga të cilët dy janë të shtetësisë së tij.

2. E njëjta procedurë ndiqet për të plotësuar vendet vakante.

3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një periudhë kohe prej 4 vjetësh. Ata mund të zgjidhen vetëm një herë. Megjithatë, për sa u përket anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë, funksionet e tre anëtarëve do të marrin fund pas një periudhe dyvjeçare. Anëtarët, funksionet e të cilëve mbarojnë në fund të periudhës fillestare dyvjeçare, caktohen me hedhje shorti, që kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, menjëherë pasi ka përfunduar zgjedhja e parë.

### Neni 6

1. Komiteti mbledhet me detyrë të mbyllura. Komiteti përbëhet nga shumica e anëtarëve të tij. Vendimet e Komitetit merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 10, paragrafi 2.

2. Komiteti harton rregulloren e tij të brendshme.

3. Sekretariati i Komitetit kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

## KAPITULLI III

### Neni 7

1. Komiteti organizon vizita në vendet e parashikuara në nenin 2. Përveç vizitave periodike, Komiteti mund të organizojë çfarëdo vizite tjetër që atij do t’i duket e arsyeshme.

2. Në përgjithësi, vizitat do të kryhen nga të paktën dy anëtarë të Komitetit. Ky i fundit, kur e quan të nevojshme, mund të kërkojë ndihmën e ekspertëve dhe të interpretëve.

#### Neni 8

1. Komiteti njofton qeverinë e Palës mbi qëllimin e tij për të kryer vizitën. Pas një njoftimi të tillë, Komiteti mundet, në çdo kohë, të vizitojë vendet e parashikuara në nenin 2.

2. Palët duhet t'i sigurojnë Komitetit lehtësirat e mëposhtme për kryerjen e detyrës së tij:

a) mundësinë për të hyrë në territorin e tij dhe për të lëvizur lirisht;

b) të gjitha të dhënat mbi vendet ku ndodhen personat e privuar nga liria;

c) mundësi të pakufizuar për të hyrë në çdo vend ku ndodhen persona të privuar nga liria, përfshirë këtu të drejtën për të lëvizur lirisht në brendësi të këtyre vendeve;

d) çdo informacion tjetër që disponon Pala dhe që i nevojitet Komitetit për kryerjen e detyrës së tij. Duke kërkuar këtë informacion, Komiteti mban parasysh kërkesat e ligjit dhe të deontologjisë të zbatueshme në planin kombëtar;

3. Komiteti mund të bisedojë pa dëshmitarë me persona të privuar nga liria.

4. Komiteti mund të komunikojë lirisht me çdo person që ai e mendon se mund t'i japë informata të dobishme.

5. Kur është rasti, Komiteti ua komunikon menjëherë vërejtjet autoriteteve kompetente të Palës së interesuar.

#### Neni 9

1. Në rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet kompetente të Palës përkatëse mund t'i bëjnë të njohur Komitetit objeksionet e tyre për vizitën lidhur me kohën ose vendin që Komiteti ka ndërmend të vizitojë. Objeksione të tilla mund të bëhen vetëm për arsye të mbrojtjes kombëtare, të sigurimit publik ose të trazirave të rënda në vendet ku personat janë privuar nga liria, për shkak të gjendjes shëndetësore të një personi ose të zhvillimit të një seance hetimi urgjente në lidhje me një shkelje të rëndë penale.

2. Në vijim të objeksioneve të tilla, Komiteti dhe Pala konsultohen menjëherë, me qëllim që të sqarojnë gjendjen dhe për të arritur në një marrëveshje për masat që do t'i lejojnë Komitetit të ushtrojë funksionet e tij sa më shpejt që të jetë e mundur. Këto masa mund të përfshijnë transferimin në një vend tjetër të të gjithë personave që Komiteti ka ndërmend të vizitojë. Në pritje të vizitës, Pala i jep Komitetit informacionin e nevojshëm mbi të gjithë personat në fjalë.

#### Neni 10

1. Pas çdo vizite, Komiteti harton një raport mbi faktet e konstatuara gjatë saj, duke mbajtur parasysh të gjitha vërejtjet që mund të paraqesë Pala e interesuar. Ai i transmeton kësaj të fundit raportin e tij me

rekomandimet që ai i quan të nevojshme. Komiteti mund të konsultohet me Palën për të sugjeruar, sipas rastit, përmirësime në mbrojtjen e personave të privuar nga liria.

2. Në qoftë se Pala nuk bashkëpunon ose refuzon të përmirësojë gjendjen në dritën e rekomandimeve të Komitetit, ky i fundit mund të vendosë, me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij, pasi Pala të ketë pasur mundësi të japë shpjegimet e saj, të lëshojë një deklaratë publike në lidhje me këtë çështje.

#### Neni 11

1. Informacionet e mbledhura nga komiteti gjatë vizitës, raportit dhe konsultimet e tij me Palën e interesuar janë konfidenciale.

2. Komiteti e boton raportin e tij, si dhe çdo shpjegim të Palës së interesuar kur ajo kërkohet nga kjo e fundit.

3. Megjithatë, asnjë e dhënë me karakter personal, nuk duhet të bëhet publike pa pëlqimin e qartë të personit në fjalë.

#### Neni 12

Çdo vit Komiteti i parashtron Komitetit të Ministrave, duke mbajtur parasysh rregullat e fshehtësisë të përmendura në nenin 11, një raport të përgjithshëm mbi aktivitetet e tij, i cili i përcillet Asamblesë Konsultative dhe bëhet publik.

#### Neni 13

Anëtarët e Komitetit, ekspertët dhe personat e tjerë që e ndihmojnë gjatë mandatit të tyre dhe pas tij i nënshtrohen detyrimit për të mbajtur të fshehta faktet ose informatat për të cilat ata kanë marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

#### Neni 14

1. Emrat e personave që ndihmojnë Komitetin përmenden në njoftimin që bëhet në bazë të nenit 8, paragrafi 1.

2. Ekspertët veprojnë mbi bazën e udhëzimeve dhe nën autoritetin e Komitetit. Ata duhet të kenë njohuri e eksperiencë të veçantë në fushat e mbuluara nga kjo Konventë dhe duhet të respektojnë të njëjtat detyrime për të qenë të pavarur, të paanshëm dhe të gatshëm, si dhe anëtarët e Komitetit.

3. Në raste të veçanta, shteti Palë mund të deklarojë se një ekspert ose ndonjë tjetër person që ndihmon Komitetin nuk mund të pranohet të bëjë vizita në vendet nën juridiksionin e tij.

## KAPITULLI IV

## Neni 15

Çdo Palë i komunikon Komitetit emrin dhe adresën e autoritetit që është kompetent për të marrë njoftimet që i drejtohen qeverisë së tij, si dhe emrin dhe adresën e çdo përfaqësuesi ndërlidhës që ajo mund të ketë caktuar.

## Neni 16

Komiteti, anëtarët dhe ekspertët e tij, të përmendur në nenin 7, paragrafi 2, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara nga shtojca e kësaj Konvente.

## Neni 17

1. Kjo Konventë nuk cenon ligjet e brendshme ose marrëveshjet ndërkombëtare që u sigurojnë një mbrojtje më të madhe personave të privuar nga liria.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet si një kufizim ose shmangie nga kompetencat e organeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose nga detyrimet që kanë Palët në bazë të kësaj Konvente.

3. Komiteti nuk do të vizitojë vendet që përfaqësuesit ose të dërguarit e fuqive protektore ose të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq vizitojnë efektivisht dhe në mënyrë të rregullt në bazë të Konventave të Gjenezës të 12 gushtit 1949 dhe të protokolleve të tyre shtojcë të 8 qershorit 1977.

## KAPITULLI V

## Neni 18

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga ana e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo do të parashtrohet për ratifikim, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

## Neni 19

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të një periudhe tremujore, pas datës kur shtatë shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të shprehin pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Konventën në përputhje me dispozitat e nenit 18.

2. Për çdo shtet anëtar, që do ta shprehë më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

## Neni 20

1. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit,

pranimit ose miratimit, të caktojë territorin ose territoret në të cilat do të gjejë zbatim kjo Konventë.

2. Çdo shtet mundet, në çdo moment, më pas, me anën e një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Për këtë territor, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të një periudhe tremujore pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve paraardhës, mund të tërhiqet për sa i përket çdo territori të përcaktuar në këtë deklaratë me anën e një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vjen pas përfundimit të një periudhe tremujore, pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

## Neni 21

Asnjë rezervë nuk pranohet në lidhje me dispozitat e kësaj Konvente.

## Neni 22

1. Çdo Palë mund ta denoncojë në çdo moment këtë Konventë, duke i dërguar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Denoncimi do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vijon pas përfundimit të një periudhe 12-mujore pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

## Neni 23

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës iu njofton shteteve anëtare të Këshillit të Evropës:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimim e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit ose miratimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas neneve të saj 19 dhe 20;
- d) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë, me përjashtim të masave të parashikuara në nenet 8 dhe 10;

Duke u bazuar në sa më lart nënshkruesit, rregullisht të autorizuar për këtë, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 26 nëntor 1987, në frëngjisht dhe në anglisht, duke qenë të dyja tekstet njëjloj të besueshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'iu dërgojë nga një kopje të vërtetuar të njëjtë me origjinalin çdo shteti anëtar të Këshillit të Evropës.

## SHTOJCË

### *Privilegjet dhe imunitetet (neni 16)*

1. Kjo shtojcë përcakton se referencat për anëtarët e Komitetit përfshijnë edhe ekspertët e përmendur në nenin 7, paragrafi 2.

2. Anëtarët e Komitetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe gjatë udhëtimeve të bëra në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të tyre, do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që vijojnë:

a) imunitet ndaj arrestimit ose burgimit, si dhe kapjes së bagazheve të tyre personale dhe, kur është fjala për veprime të kryera prej tyre në cilësinë zyrtare, përfshirë këtu fjalët e thëna e të shkruara, imunitet ndaj çdo procesi gjyqësor;

b) përjashtim nga të gjitha masat shtrënguese në lidhje me lirinë e tyre të lëvizjes: dalje dhe hyrje në vendin e tyre të banimit dhe hyrje dhe dalje nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre, si edhe nga të gjitha formalitetet e regjistrimit të të huajve në vendet e vizituara ose të përshkruara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

3. Gjatë udhëtimeve të kryera në kohën e ushtrimit të funksioneve të tyre, anëtarëve të Komitetit, në lidhje me doganën dhe kontrollin e valutës, do t'iu njihen:

a) nga qeveritë e tyre, të njëjtat lehtësi që këto u njohin funksionarëve të lartë që shkojnë jashtë shtetit me mision të përkohshëm zyrtar;

b) nga qeveritë e Palëve të tjera, të njëjtat lehtësi që këto u njohin përfaqësuesve të qeverive të huaja me mision të përkohshëm zyrtar.

4. Dokumentet dhe letrat e Komitetit janë të paprekshme, për aq sa i përkasin veprimtarisë së Komitetit. Korrespondenca zyrtare dhe komunikimet e tjera zyrtare të Komitetit nuk mund të kapen ose të censurohen.

5. Me qëllim që anëtarëve të Komitetit, t'u sigurohet liria e plotë e fjalës dhe një pavarësi e plotë në përmbushjen e funksioneve të tyre, imuniteti gjyqësor në lidhje me fjalët e thëna ose me shkrimet ose me veprimet e kryera prej tyre gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, do të vazhdojë t'u njihet edhe pasi mandati i këtyre personave të ketë marrë fund.

6. Privilegjet dhe imunitetet u jepen anëtarëve të Komitetit jo për përfitimin e tyre personal, por me qëllim që të sigurojnë pavarësi të plotë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Vetëm Komiteti ka të drejtë të heqë imunitetet e anëtarëve të tij; ai jo vetëm ka të drejtën, por edhe detyrën që t'ia heqë imunitetin ndonjërit prej anëtarëve të tij, në të gjitha rastet kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte që të dalë e drejta ose kur imuniteti mund të hiqet pa dëmtuar qëllimin për të cilin është akorduar.

## XIX. KONVENTA EVROPIANE E EKSTRADIMIT

Paris, 13 dhjetor 1957

Hyrë në fuqi më 18 prill 1960, në përputhje me nenin 29;

Teksti: Këshilli i Evropës, Seria e Traktateve Evropiane nr. 24.

Qeveritë nënshkruese, anëtare të Këshillit të Evropës,

*Duke marrë* parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të vet;

*Duke marrë* parasysh se ky objektiv mund të arrihet me marrëveshje ose me një veprim të përbashkët në lëmin juridik;

*Të bindura se* pranimi i rregullave uniforme lidhur me ekstradimin ndihmon për ta çuar përpara bashkimin në fjalë;

janë marrë vesh për sa vijon:

### Neni 1

#### **Detyrimet e ekstraduesit**

Palët kontraktuese zotohen t'i dorëzojnë njëra-tjetrës, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara nga nenet që vijojnë, ata individë që ndiqen për shkelje të ligjit ose kërkohen nga organet gjyqësore të Palës kërkuese për të vuajtur një dënim ose një masë sigurimi.

### Neni 2

1. I japin shkas ekstradimit veprat që ndëshkohen nga ligjet e Palës kërkuese dhe të Palës së kërkuar me privimin e lirisë ose me një masë sigurimi privuese të lirisë, e shumta deri në një vit ose edhe më rëndë. Kur zbatohet një dënim ose një masë ndëshkimore sigurimi në territorin e Palës kërkuese, dënimi i dhënë duhet të jetë të paktën katër muaj.

2. Në rast se kërkesa për ekstradim ka parasysh shumë vepra të ndryshme të dënueshme, secila nga ligjet e Palës kërkuese dhe të Palës së kërkuar me një dënim privues të lirisë ose me një masë sigurimi privuese të lirisë, por kur disa syresh, nuk e plotësojnë kushtin lidhur me masën e dënimit, Pala së cilës i kërkohet, ka prapëseprapë të drejtën të akordojë ekstradimin për këta të fundit.

3. Çdo Palë kontraktuese, legjislacioni i së cilës nuk e lejon ekstradimin për disa shkelje që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, ka mundësi për sa i përket asaj, t'i heqë këto shkelje nga fusha e zbatimit të Konventës.

4. Çdo Palë kontraktuese, që do të dëshironte të mbështetej në mundësinë e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në çastin e depozitimit të

instrumentit të vet të ratifikimit ose të aderimit, ose një listë të shkeljeve për të cilat ekstradimi lejohet, ose një listë me shkeljet për të cilat ekstradimi përjashtohet, duke treguar dispozitat ligjore që lejojnë ose përjashtojnë ekstradimin. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'ua dërgojë këto lista nënshkruesve të tjerë.

5. Në qoftë se më tej do të ketë shkelje të tjera të përjashtuara nga ekstradimi prej legjislacionit të një Pale kontraktuese, kjo do t'ia njoftojë këtë përjashtim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, i cili informon nënshkruesit e tjerë. Ky njoftim merr efekt në fund të një afati tremujor, duke filluar nga data e marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Çdo Palë që do të ketë shfrytëzuar mundësinë e parashikuar në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni, ka të drejtë që në çdo kohë t'ia nënshtrojë zbatimit të kësaj Konvente shkeljet që kanë qenë përjashtuar. Ajo do t'ia njoftojë këto ndryshime Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, i cili do t'ua dërgojë nënshkruesve të tjerë.

7. Çdo Palë mund të zbatojë rregulloren e reciprocitetit për sa u përket shkeljeve të përjashtuara nga fusha e zbatimit të Konventës që mbështetet në këtë nen.

### Neni 3

#### Shkelje politike

1. Ekstradimi nuk akordohet në rast se shkelja për të cilën është kërkuar konsiderohet nga Pala e kërkuar si një shkelje politike ose si një fakt që lidhet me këtë shkelje.

2. I njëjti rregull do të zbatohet në rast se Pala e kërkuar ka arsye serioze të besojë se kërkesa për ekstradim është motivuar me një shkelje që përbën faj ordiner, por është paraqitur me qëllim që të ndiqet ose të dënohet një individ për arsye race, feje, kombësie dhe opinionit politik, ose kur pozita e këtij individ rrezikon të rëndohet për njërin apo tjetrin nga këto arsye.

3. Lidhur me zbatimin e kësaj Konvente, atentati kundër jetës së një kryetari shteti ose një anëtarit të familjes së tij nuk do të konsiderohet shkelje politike.

4. Zbatimi i këtij neni nuk do të cenojë detyrimet që Palët do të kenë marrë përsipër ose do të marrin mbi bazën e çdo Konvente tjetër ndërkombëtare të karakterit shumëpalësh.

### Neni 4

#### Shkelje ushtarake

Ekstradimi për arsye të shkeljeve ushtarake që nuk janë shkelje ordinere përjashtohet nga fusha e zbatimit të kësaj Konvente.

### Neni 5

#### Shkelje financiare

Në fushën e taksave dhe të tatimeve, doganës, këmbimit të monedhave, ekstradimi do të akordohet në

kushtet e parashikuara nga kjo Konventë, vetëm nëse është vendosur kështu midis Palëve kontraktuese për çdo shkelje ose kategori shkeljesh.

### Neni 6

#### Ekstradimi i shtetasve

1. a) Çdo Palë kontraktuese do të ketë të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të vet.

b) Çdo Palë kontraktuese do të ketë mundësi, në një deklaratë të bërë në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit ose të aderimit, të përkufizojë, për sa i përket asaj, fjalën "shtetas" në kuptimin që i jep kjo Konventë.

c) Cilësimi "shtetas" do të vlerësohet në kohën e vendimit për ekstradim. Mirëpo, në rast se ky cilësim njihet vetëm ndërmjet kohës së vendimit dhe datës së parashikuar për dorëzim, Pala e kërkuar mundet, gjithashtu, të mbështetet në dispozitën e kryerreshtit a të këtij paragrafi.

2. Në qoftë se Pala e kërkuar nuk e ekstradon shtetasin e vet, ajo duhet me kërkesën e Palës tjetër, t'ua parashtrijë problemin autoriteteve kompetente, në mënyrë që ndjekjet gjyqësore të mund të ushtrohen, po të jetë rasti. Për këtë qëllim, dosjet, informatat dhe objektet, që kanë të bëjnë me shkeljen, do të dërgohen falas përmes rrugës së parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12. Pala kërkuese do të informohet lidhur me rrugën që do t'i jepet kërkesës së saj.

### Neni 7

#### Vendi i kryerjes së shkeljes

1. Pala e kërkuar mund ta refuzojë ekstradimin e një personi që është kërkuar për shkak të një shkeljeje, e cila sipas legjislacionit të saj, është bërë tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj ose në një vend të përafërt me territorin e saj.

2. Kur shkelja, që përlligj kërkesën e ekstradimit, kryhet jashtë territorit të Palës kërkuese, ekstradimi mund të refuzohet vetëm kur legjislacioni i Palës së kërkuar nuk autorizon ndjekjen për një shkelje të njëjtë, të bërë jashtë territorit të saj, ose nuk e autorizon ekstradimin për shkeljen që është objekt i kërkesës.

### Neni 8

#### Ndjekje në vazhdim për të njëjtat vepra

Një Palë e kërkuar mund ta refuzojë ekstradimin që kërkohet për një person, kur ky bëhet objekt ndjekjeje prej saj për një ose më shumë vepra për të cilat kërkohet ekstradimi.

### Neni 9

#### "Non bis in idem"

Ekstradimi nuk akordohet kur individ i kërkuar është gjykuar përfundimisht nga autoritetet kompetente

të Palës së kërkuar për një ose më shumë vepra që janë bërë shkas për kërkesën e ekstradimit. Ekstradimi mund të refuzohet nëse autoritetet kompetente të Palës së kërkuar vendosin të mos ndërmarrin ndjekje ose t'u japin fund ndjekjeve që kanë bërë për të njëjtën ose të njëjtat vepra.

#### Neni 10 **Parashkrimi**

Ekstradimi nuk akordohet nëse parashkrimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të Palës që kërkon, qoftë nga ai i Palës së kërkuar.

#### Neni 11 **Dënimi me vdekje**

Në rast se vepra, mbi bazën e së cilës kërkohet ekstradimi, ndëshkohet me dënimin me vdekje nga ligji i Palës kërkuese dhe, në këtë rast, ky dënim nuk parashikohet në legjislacionin e Palës së kërkuar ose kur në përgjithësi nuk zbatohet në atë vend, ekstradimi mund të mos akordohet, përveçse me kusht që Pala kërkuese të japë sigurime të vlerësuar të mjaftueshme nga Pala e kërkuar, se dënimi me vdekje nuk do të zbatohet.

#### Neni 12 **Kërkesa dhe dokumente në mbështetje të saj**

1. Kërkesa formulohet me shkrim dhe paraqitet në rrugë diplomatike. Një rrugë tjetër mund të caktohet me marrëveshje të drejtpërdrejtë midis dy ose më shumë Palëve.

2. Do të paraqiten në mbështetje të kërkesës:

a) origjinali ose kopja e vërtetuar autentike, qoftë ajo e vendimit për një dënim për t'u zbatuar, qoftë ajo e një urdhri arresti ose çdo akti tjetër që ka të njëjtën fuqi vepruese, lëshuar sipas rregullave që përmban ligji i Palës kërkuese;

b) një pasqyrë të fakteve në bazë të të cilave është kërkuar ekstradimi. Koha dhe vendi i kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së shkeljeve në fjalë, cilësimi i tyre ligjor dhe referimet ndaj dispozitave ligjore që janë të zbatueshme në këto raste, të cilat duhet të përcaktohen sa më saktë të jetë e mundur;

c) një kopje të dispozitave ligjore të zbatueshme ose në rast se kjo nuk është e mundur, një deklaratë mbi të drejtën e zbatueshme, si dhe një përshkrim sa më të saktë të tipareve të individit të kërkuar, si dhe çdo informacion që mund të shërbejë për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e tij.

#### Neni 13 **Informata plotësuese**

Në rast se të dhënat e njoftuara nga Pala kërkuese konsiderohen të pamjaftueshme për t'i dhënë mundësi

Palës së kërkuar të marrë një vendim mbi bazën e kësaj Konvente, ajo do të kërkojë plotësimin e informatave të nevojshme dhe mund të caktojë një afat për sigurimin e këtyre informatave.

#### Neni 14 **Rregulla e specialitetit**

1. Individit që dorëzohet nuk duhet të ndiqet, as të gjykohet dhe as të burgoset për vuajtjen e një dënimi ose të një mase sigurimi; as duhet t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale për çfarëdo veprim që është kryer para dorëzimit, dhe që nuk hyn në motivet e ekstradimit, me përjashtim të këtyre rasteve:

a) kur Pala që e ka dorëzuar jep pëlqimin e vet. Për këtë qëllim bëhet një kërkesë, e shoqëruar kjo me dokumentet që parashikohen në nenin 12 dhe në një proces verbal gjyqësor me deklaratimet e të ekstraduarit. Ky pëlqim do të njoftohet kur shkelja, për të cilën ai është kërkuar, përmban në vetvete detyrimin e ekstradimit të bazuar në këtë Konventë;

b) edhe pasi ka pasur mundësinë të largohet, individit i ekstraduar nuk është larguar gjatë 45 ditëve që pasojnë lirimin e tij përfundimtar nga territori i Palës së cilës i është dorëzuar ose kur është rikthyer aty pasi është larguar.

2. Megjithatë, Pala kërkuese mund të marrë masat e nevojshme në rast se nga njëra anë, ndodhet para një lirimi eventual të individit në fjalë nga territori dhe, nga ana tjetër, në rast të ndërprerjes së parashkrimit në përputhje me legjislacionin e saj, duke përfshirë përdorimin e një procedure me mungesa.

3. Kur cilësimi i veprës së inkriminuar ndryshohet gjatë procedurës, individit i ekstraduar nuk do të ndiqet e as do të gjykohet, veçse kur elementet përbërëse të shkeljes, që është cilësuar sërish, lejojnë ekstradimin.

#### Neni 15 **Riekstradimi në një shtet të tretë**

Me përjashtim të rastit të parashikuar në paragrafin 1, kryerreshti "b" i nenit 14, pëlqimi i Palës së kërkuar do të jetë i nevojshëm për t'i dhënë mundësi Palës kërkuese t'i dorëzojë një Pale tjetër apo një shtet të tretë individin që i është kthyer dhe është kërkuar nga Pala tjetër ose nga shteti i tretë për shkelje të kryera para dorëzimit. Pala e kërkuar mund të vërë si kusht paraqitjen e dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 12.

#### Neni 16 **Arrestimi i përkohshëm**

1. Në raste urgjente, autoritet kompetente të Palës kërkuese mund të kërkojnë arrestimin e përkohshëm të individit që kërkohet; autoritetet kompetente të Palës së kërkuar vendosin për këtë kërkesë në përputhje me ligjin e kësaj Pale.

2. Në kërkesën për arrestim të përkohshëm do të shënohet ekzistenca e njërit prej dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2, kryerreshti "a" i nenit 12 dhe do të theksohet se për këtë do të dërgohet një kërkesë për ekstradim; aty do të përmendet shkelja për të cilën do të kërkohet ekstradimi, koha dhe vendi ku është kryer ajo, si dhe brenda mundësive të dhënat rreth individit që kërkohet.

3. Kërkesa për arrestim të përkohshëm do t'u transmetohet autoriteteve kompetente të Palës së kërkuar ose me rrugë diplomatike, ose drejtpërsëdrejti me postë ose me telegram, ose përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol), ose me çdo mjet tjetër që lëshon një vërtetim të shkruar, ose që pranohet nga Pala e kërkuar. Autoriteti kërkues do të njoftohet pa vonesë lidhur me rrugën që i është dhënë kërkesës së tij.

4. Arrestimi i përkohshëm mund të marrë fund në rast se brenda një afati prej 18 ditësh pas arrestimit, Pala e kërkuar nuk ka marrë njoftim për kërkesën e ekstradimit dhe për dokumentet shoqëruese që përmenden në nenin 12; në asnjë rast ajo nuk duhet të kalojë përtej 40 ditëve pas arrestimit. Sidoqoftë, lirimi i përkohshëm është i mundshëm në çdo kohë, por Pala e kërkuar duhet të marrë çdo masë që e quan të nevojshme për të shmangur arratisjen e individit të kërkuar.

5. Lirimi nuk përjashton një arrestim të dytë dhe ekstradimin në rast se kërkesa për ekstradim mbërrin më vonë.

#### Neni 17

##### **Konkurrim kërkesash**

Në rast se ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ose për të njëjtën vepër, ose për vepra të ndryshme, Pala e kërkuar vendos, duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat, sidomos sa e rëndë është shkelja, vendin e kryerjes së shkeljes, datat e kërkesave, shtetësinë e individit që kërkohet, si dhe mundësinë e një ekstradimi të mëtejshëm në një shtet tjetër.

#### Neni 18

##### **Dorëzimi i të ekstraduarit**

1. Pala e kërkuar informon Palën kërkuese përmes rrugës së parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12 lidhur me vendimin e saj për ekstradimin.

2. Çdo refuzim i plotë ose i pjesshëm duhet të jetë i arsyeshëm.

3. Në rast pranimi, Pala kërkuese informohet për vendin dhe datën e dorëzimit, si dhe për kohëzgjatjen e burgimit që ka vuajtur individi i kërkuar lidhur me ekstradimin.

4. Lidhur me rezervën që parashikon paragrafi 5 i këtij neni, kur individi i kërkuar nuk është pritur në

datën e caktuar, ai mund të lihet i lirë pas skadimit të një fati 15-ditësh, duke filluar nga data në fjalë, në çdo rast, ai do të lirohet pas skadimit të një afati 30-ditësh; Pala e kërkuar mund të refuzojë të ekstradojë për të njëjtën vepër.

5. Në rast force madhore, që pengon dorëzimin ose pritjen e individit që ekstradohet, Pala e interesuar informon për këtë Palën tjetër; të dyja Palët bien dakord për një datë tjetër të dorëzimit, dhe dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni janë përsëri të zbatueshme.

#### Neni 19

##### **Dorëzimi i shtyrë ose i kushtëzuar**

1. Pala e kërkuar mundet, pasi të ketë vendosur për kërkesën e ekstradimit, ta shtyjë dorëzimin e individit të kërkuar, në mënyrë që ky të mund të ndiqet prej saj ose, në rast se është dënuar më përpara, të mund të vuajë dënimin në territorin e saj, kur ky dënim është dhënë për shkak të një veprë që nuk ka të bëjë me ekstradimin e kërkuar.

2. Në vend që të shtyjë dorëzimin, Pala e kërkuar mund t'ia dorëzojë përkohësisht Palës kërkuese individin e kërkuar, në kushte që përcaktohen me një marrëveshje të përbashkët të Palëve.

#### Neni 20

##### **Dorëzimi i objekteve**

1. Me kërkesën e Palës kërkuese, Pala e kërkuar mbledh dhe dorëzon, në shkallën e lejuar nga ligjet e saj këto objekte:

a) ato që mund të shërbejnë si dokumente të akuzës; ose

b) ato që lidhen me shkeljen dhe që i janë gjetur individit të kërkuar në çastin e arrestimit ose janë zbuluar më pas.

2. Dorëzimi i objekteve, që përmendëm në paragrafin 1 të këtij neni, do të kryhet edhe në rastin kur ekstradimi, tashmë i akorduar, nuk mund të zbatohet për shkak të vdekjes ose të arratisjes së individit të kërkuar.

3. Kur këto objekte i nënshtrohen ndalimit ose sekuestrimit në territorin e Palës së kërkuar, kjo e fundit mundet, në kuadrin e një procedure penale që është në vazhdim, t'i mbajë ato përkohësisht ose t'i dorëzojë me kusht rikthimi.

4. Megjithatë, janë të rezervuara të drejtat që Pala e kërkuar apo të tjerë mund të kenë siguruar mbi këto objekte. Në rast se ekzistojnë të drejta të tilla, kur të mbarojë procesi, objektet në fjalë do t'i rikthehen sa më parë që të jetë e mundur dhe pa shpërblim Palës së kërkuar.



Neni 21

**Kalimi nëpër një territor**

1. Kalimi transit nëpër territorin e njëres prej Palëve kontraktuese do të lejohet me një kërkesë që dërgohet me rrugën e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 12, me kusht që të mos ketë shkelje, të cilën Pala së cilës i kërkohet kalimi transit, e konsideron të karakterit politik ose thjesht ushtarak sipas neneve 3 dhe 4 të kësaj Konvente.

2. Kalimi i një shtetasi të vendit, të cilit i është kërkuar transiti sipas kuptimit të nenit 6, mund të refuzohet.

3. Me rezervën e dispozitave të paragrafit 4 të këtij neni, paraqitja e dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 12, është kusht i domosdoshëm.

4. Në rastin kur përdoret rruga ajrore, zbatohen këto dispozita:

a) kur nuk është parashikuar asnjë ulje avioni, Pala kërkuese do të njoftojë, mbi territorin e së cilës do të fluturojë avioni, dhe njëkohësisht do të tregojë një prej dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2, kryerreshti "a" të nenit 12. Në rast uljeje të parashikuar të avionit, ky njoftim do të ketë efektin e një kërkesë për arrestimin e përkohshëm sipas nenit 16 dhe Pala kërkuese në këtë rast do të dërgojë një kërkesë të rregullt për kalimin transit;

b) kur ulja e avionit është e parashikuar, Pala kërkuese dërgon një kërkesë të rregullt për kalim transit.

5. Megjithatë, një Palë mund të deklarojë, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente ose depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose të aderimit, ose nuk do ta lejojë kalimin transit të një individi veçse në të njëjtat kushte si ato të ekstradimit ose të disa prej këtyre kushteve. Në këto raste rregulli i reciprocitetit mund të zbatohet.

6. Kalimi transit i individit të ekstraduar nuk mund të bëhet nëpër një territor, ku mund të besohet se jeta ose liria e tij mund të rrezikohen për shkak të racës, fesë, kombësisë ose opinioneve të tij politike.

Neni 22

**Procedura**

Përveç rasteve kur kjo Konventë vendos ndryshe, ligji i Palës së kërkuar është i zbatueshëm për procedurën e ekstradimit, si dhe për atë të arrestimit të përkohshëm.

Neni 23

**Gjuhët që përdoren**

Dokumentet që duhen paraqitur hartohen ose në gjuhën e Palës kërkuese, ose në atë të Palës së kërkuar. Kjo e fundit mund të kërkojë një përkthim në gjuhën zyrtare të Këshillit të Evropës që ajo e zgjedh.

Neni 24

**Shpenzimet**

1. Shpenzimet që bëhen lidhur me ekstradimin në territorin e Palës së kërkuar janë në ngarkim të kësaj Pale.

2. Shpenzimet që bëhen lidhur me kalimin nëpër territorin e Palës së cilës i është kërkuar kalimi janë në ngarkim të Palës kërkuese.

3. Në raste ekstradimi nga një territor jometropolitan i Palës së kërkuar, shpenzimet lidhur me transportin midis këtij territori dhe territorit metropolitan të Palës kërkuese janë në ngarkim të kësaj të fundit. E njëjta gjë vlen edhe për shpenzimet e bëra lidhur me transportin ndërmjet territorit jometropolitan të Palës së kërkuar dhe territorit metropolitan të huaj.

Neni 25

**Përkufizimi i "masave të sigurimit"**

Në kuptimin e kësaj Konvente, shprehja "masa sigurimi" tregon çdo lloj masash që merren për të kufizuar lirinë, masa që vendosen për të plotësuar ose zëvendësuar një dënim të dhënë nga një juridiksion penal.

Neni 26

**Rezervat**

1. Në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit ose të aderimit, çdo Palë kontraktuese do të ketë mundësi të formulojë rezerva për një ose më shumë dispozita të përcaktuara nga Konventa.

2. Çdo Palë kontraktuese që do të ketë formuluar një rezervë do ta tërheqë atë sapo rrethanat do ta lejojnë. Tërheqja e rezervave do të bëhet me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

3. Një Palë kontraktuese, që formulon një rezervë ndaj një dispozite të Konventës, nuk mund të pretendojë që kjo dispozitë të zbatohet nga një Palë tjetër, përveçse kur kjo vetë do ta ketë pranuar.

Neni 27

**Fusha e zbatimit territorial**

1. Kjo Konventë do të zbatohet në territoret metropolitane të Palëve kontraktuese.

2. Ajo do të zbatohet, gjithashtu, në rastin e Francës, për Algjerinë dhe departamentet e përtej detit dhe në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, Britanisë së Madhe dhe të Irlandës së Veriut, për ishujt Anglo-Normandë dhe ishullin e Manit.

3. Republika Federale e Gjermanisë mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në Landin e Berlinit me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Ky i fundit do t'ua njoftojë këtë deklaratë Palëve të tjera.

4. Me një marrëveshje të drejtpërdrejtë midis dy ose më shumë Palëve kontraktuese, fusha e zbatimit të kësaj Konvente mund të shtrihet me kushtet që përmban kjo marrëveshje për çdo territor të njëres prej këtyre Palëve, përveç atyre që përmenden në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, ndaj të cilit një nga Palët siguron marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 28

#### **Raporti midis kësaj Konvente dhe marrëveshjeve dypalëshe**

1. Kjo Konventë shfuqizon, lidhur me territoret ndaj të cilëve zbatohet, ato dispozita të traktateve, konventave ose marrëveshjeve dypalëshe, të cilat, midis dy Palëve kontraktuese, merren me çështje të ekstradimit.

2. Palët kontraktuese nuk mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, veçse për të përmbushur dispozitat e kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmban kjo Konventë.

3. Kur midis dy ose më shumë Palëve kontraktuese, ekstradimi bëhet mbi bazën e një legjislacioni uniform, Palët do të kenë mundësi të rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella lidhur me ekstradimin, duke u mbështetur vetëm në këtë sistem, pavarësisht nga dispozitat e kësaj Konvente. I njëjti parim ka për të qenë i zbatueshëm midis dy ose më shumë Palëve kontraktuese, kur secila ka në fuqi një ligj që parashikon zbatimin në territorin e vet të fletëarresteve që janë lëshuar në territorin e tjetres Palë ose të Palëve të tjera. Palët kontraktuese që përjashtojnë ose mund të vendosin të përjashtonin nga marrëdhëniet e tyre reciproke zbatimin e kësaj Konvente, në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi, duhet t'i dërgojë për këtë një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Ky do t'u dërgojë Palëve të tjera kontraktuese çdo njoftim që do të ketë marrë mbi bazën e këtij paragrafi.

Neni 29

#### **Nënshkrimi, ratifikimi, hyrja në fuqi**

1. Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur për nënshkrim nga anëtarët e Këshillit të Evropës. Ajo do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit.

2. Konventa do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit.

3. Ajo do të hyjë në fuqi në raport me çdo Palë nënshkruese, e cila do ta ratifikojë më pas, 90 ditë pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit.

Neni 30

#### **Aderimi**

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë Konventë. Rezoluta lidhur me këtë ftesë duhet të ketë miratimin e njëzëshëm të anëtarëve të Këshillit që e kanë ratifikuar Konventën.

2. Aderimi bëhet duke depozituar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit një instrument aderimi që merr efekt 90 ditë pas depozitimit të tij.

Neni 31

#### **Denoncimi**

Çdo Palë kontraktuese ka të drejtë, aq sa i takon asaj, ta denoncojë këtë Konventë duke i dërguar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Ky dokument merr efekt 6 muaj pas ditës së marrjes së njoftimit përkatës nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

Neni 32

#### **Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton anëtarët e Këshillit dhe qeverinë e çdo shteti që ka aderuar në këtë Konventë:

a) për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të aderimit;

b) për datën e hyrjes në fuqi;

c) për çdo deklaratë që është bërë në zbatim të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 6 dhe të paragrafit 5 të nenit 21;

d) për çdo rezervë që do të jetë formuluar në zbatim të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 26;

e) për tërheqjen e çdo rezerve të paraqitur në zbatim të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 26;

f) për çdo njoftim lidhur me denoncimin që është marrë në zbatim të dispozitave të nenit 31 të kësaj Konvente dhe datën kur ky denoncim merr efekt.

Duke u mbështetur në sa më sipër, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Paris, më 13 dhjetor 1957 në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet të barasvlershme, në një kopje të vetme, që do të depozitohet në arkivin e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit do t'u dërgojë një kopje të vërtetuar, të njëjtë me origjinalin, qeverive nënshkruese.

## PROTOKOLLI SHITESË I KONVENTËS EVROPIANE PËR EKSTRADIMIN

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokollit,

*Duke pasur* parasysh dispozitat e Konventës Evropiane për Ekstradimin që është hapur për nënshkrim në Paris, më 13 dhjetor 1957 (që tani e tutje do të quhet “Konventa”) dhe, në veçanti, nenet 3 dhe 9 të saj;

*Duke konsideruar* të nevojshme të plotësohen këto nene, me qëllim që të forcohet mbrojtja e principeve njerëzore dhe e individëve,

kanë rënë dakort si më poshtë:

### KAPITULLI I

#### Neni 1

Për zbatimin e nenit 3 të Konventës, kundërvajtjet me karakter politik nuk mendohet se përfshijnë të poshtëshënuarit:

a) krimet kundër njerëzimit të përcaktuara në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit të adaptuar më 9 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara;

b) shkeljet e përcaktuara në nenin 50 të Konventës së Gjenevës të vitit 1949, për Përmirësimin e Kushteve të të Plagosurve dhe të Sëmurëve në Forcat e Armatosura në Terren, nenin 51 të Konventës së Gjenevës së vitit 1949, për Përmirësimin e Kushteve të të Plagosurve, të Sëmurëve dhe Anëtarëve të Mbetur në Det të Hapur të Forcave të Armatosura, nenin 147 të Konventës së Gjenevës të vitit 1949, në lidhje me Trajtimin e të Burgosurve të Luftës dhe nenin 147 të Konventës së Gjenevës të vitit 1949, në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë;

c) çdo shkelje të kësaj natyre të ligjeve të luftës, që kanë efekt në kohën kur hyn në fuqi ky Protokoll dhe të zakoneve të luftës që ekzistojnë në atë kohë, të cilat nuk janë përcaktuar në dispozitat e sipërpërmendura të Konventës së Gjenevës.

### KAPITULLI II

#### Neni 2

1. Neni 9 i Konventës plotësohet me tekstin e mëposhtëm, në mënyrë të tillë që ish-neni 9 i Konventës të bëhet paragraf i parë dhe dispozitat e poshtëshënuara të bëhen paragrafi 2, 3 dhe 4.

“2. Ekstradimi i personit kundër të cilit është dhënë një vendim i formës së prerë në një shtet të tretë, Pala kontraktuese në Konventë, nuk i jepet për shkeljen ose shkeljet e kryera për të cilat është ngritur pretendimi:

a) nëse vendimi i sipërpërmendur është pafajësia;

b) nëse afati i burgimit ose masa tjetër me të cilën ai është dënuar:

i) është ekzekutuar plotësisht;

ii) ka qenë objekt i një faljeje ose amnistie plotësisht, ose vetëm për pjesën që nuk është ekzekutuar;

c) nëse gjykata i ka dhënë fajësinë kundërvajtësit pa i vendosur atij sanksion.

3. Megjithatë, në rastet e përmendura në paragrafin 2, mund të bëhet ekstradimi:

a) nëse kundërvajtja për të cilën është dhënë vendimi është bërë kundër një personi, një institucioni ose kujtdo që ka status publik në shtetin kërkues;

b) nëse personi kundër të cilit është dhënë vendimi ka pasur një status publik në shtetin kërkues;

c) nëse kundërvajtja në lidhje me të cilin është dhënë vendimi është kryer plotësisht ose pjesërisht në territorin e shtetit kërkues ose në një vend që trajtohet në territorin e saj.

4. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 nuk pengojnë zbatimin e dispozitave më të gjera vendase në lidhje me efektin e *ne bis in idem* që u bashkëngjitet vendimeve penale.”

### KAPITULLI III

#### Neni 3

1. Protokollin do të jetë i hapur për t'u nënshkruar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që kanë nënshkruar Konventën. Ai është objekt i ratifikimit, pranimit dhe aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe aprovimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

2. Protokollin hyn në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që e ratifikon, pranon dhe e aprovon më vonë, Protokollin hyn në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

4. Një shtet anëtar i Këshillit të Evropës mund të mos e ratifikojë, pranojë ose aprovojë këtë Protokoll pa e pasur ratifikuar më parë ose në të njëjtën kohë Konventën.

#### Neni 4

1. Secili shtet që ka hyrë në Konventë mund të hyjë në këtë Protokoll pasi Protokollin të ketë hyrë në fuqi.

2. Një anëtarësim i tillë bëhet i efektshëm duke depozituar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës një instrument të anëtarësimit që bëhet i efektshëm 90 ditë pas datës së depozitimit.

## Neni 5

1. Secili shtet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet ky Protokoll.

2. Secili shtet, në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose të anëtarësimit, ose në një datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund ta shtrijë këtë Protokoll në çdo territor tjetër ose territore të përcaktuara në deklaratë dhe për cilat marrëdhënie ndërkombëtare është përgjegjshëm dhe në emër të kujt është i autorizuar për të bërë ndërmarrje të tilla.

3. Çdo deklaratë e bërë në pajtim me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet për çdo territor të përmendur në një deklaratë të tillë në pajtim me procedurën e përcaktuar në nenin 8 të këtij Protokoll.

## Neni 6

1. Secili shtet mund të deklarojë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit që ai nuk pranon njërin nga kapitujt I ose II.

2. Çdo Palë kontraktuese mund të tërheqë një deklaratë të tillë që ajo ka bërë në pajtim me paragrafin e mësipërm me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe bëhet e efektshme që në datën e marrjes.

3. Nuk mund të bëhet asnjë rezervë në lidhje me dispozitat e këtij Protokoll.

## Neni 7

Komiteti Evropian për Problemet e Krimin të Këshillit të Evropës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e këtij Protokoll dhe bën çfarëdo që të jetë e nevojshme për të mundësuar një zgjidhje miqësore të çfarëdo vështirësie që rrjedh nga zbatimi i saj.

## Neni 8

1. Secila Palë kontraktuese mund të tërhiqet nga ky Protokoll, për aq sa ai është i interesuar, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi 6 muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Tërheqja nga Konventa shkakton automatikisht tërheqjen edhe nga Protokoll.

## Neni 9

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që kanë hyrë në Konventë, për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokoll në pajtim me nenin 3 të tij;

d) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 5 dhe çdo tërheqje të një deklarate të tillë;

e) çdo deklaratë të bërë në pajtim me dispozitat e nenit 6, paragrafi 1;

f) tërheqjen e çdo deklarate të bërë në pajtim me dispozitat e nenit 6, paragrafi 2;

g) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 8 dhe datën kur një tërheqje e tillë bëhet e efektshme.

Si dëshmitarë të kësaj, nënshkruesit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar Protokollin.

Kryer në Strasburg, 15 tetor 1975, në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet janë njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës u transmeton kopje të vërtetuar të gjithë nënshkruesve dhe shteteve që anëtarësohen.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokoll, duke dëshiruar të lehtësojnë zbatimin e Konventës për Ekstradimin e hapur për nënshkrim në Paris, më 13 dhjetor 1997 (që më pas do të quhet "Konventë"), në fushën e krimeve fiskale;

Duke e konsideruar të nevojshme mbështetjen e Konventës në aspekte të tjera, ranë dakord si më poshtë:

## KAPITULLI I

## Neni 1

Paragrafi 2 i nenit 2 të Konventës do të shtohet si më poshtë:

"kjo e drejtë do të zbatohet edhe për krimet që janë subjekt vetëm i dënimeve *pecuniare* (në para)."

## KAPITULLI II

## Neni 2

Neni 5 i Konventës do të zëvendësohet si më poshtë:  
"Krimet fiskale

1. Për krimet në lidhje me taksat, detyrimet, taksat doganore dhe *Exchange* (këmbim valute), ekstradimi do të bëhet midis vendeve kontraktuese në përputhje me parashikimet e Konventës, nëse vepra penale, sipas ligjit të vendeve kontraktuese, i korrespondon një vepre penale të së njëjtës natyrë.

2. Ekstradimi, nuk mund të refuzohet mbi bazën se ligji i Palës kërkuese nuk vendos të njëjtën lloj takse ose detyrim, ose nuk përmban një taksë, detyrim, detyrim doganor ose *exchange regulation* të të njëjtit lloj si ligji i Palës kërkuese.”

### KAPITULLI III

#### Neni 3

Konventa do të shtohet si më poshtë:

“Gjykimet në mungesë

1. Kur një Palë kontraktuese kërkon nga një Palë tjetër ekstradimin e një personi me qëllim ekzekutimin e një vendimi me burgim të dhënë në mungesë, Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin për këtë qëllim, nëse sipas mendimit të tij, procedurat e gjykimit nuk përmbushin të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për një person të akuzuar për një vepër penale. Megjithatë, ekstradimi do të jepet nëse Pala kërkuese jep garanci të mjaftueshme që personi do të rigjykohet me të drejtën e mbrojtjes. Ky vendim do të autorizojë Palën kërkuese të ekzekutojë vendimin, nëse personi i dënuar nuk kundërshton një gjë të tillë, ose të nisë procedurat e rigjykimit për personin e ekstraduar.

2. Kur Pala e kërkuar njofton personin për të cilin është kërkuar ekstradimi për gjykimin e zhvilluar në mungesë të tij, Pala kërkuese nuk do ta konsiderojë këtë komunikim si një njoftim zyrtar për qëllimet e procedurës penale në këtë shtet.”

### KAPITULLI IV

#### Neni 4

Konventa do të shtohet si më poshtë:

“Amnistia

Ekstradimi nuk do të jepet për një vepër penale në lidhje me të cilën është dhënë një amnisti në shtetin e kërkuar dhe të cilin shteti kishte kompetencë ta gjykonte sipas së drejtës së tij penale.”

### Kapitulli V

#### Neni 5

Paragrafi 1 i nenit 12 të Konventës do të zëvendësohet me parashikimet e mëposhtme:

“kërkesa do të jetë me shkrim dhe duhet të adresohet nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese te Ministria e Drejtësisë së Palës së kërkuar; megjithatë, përdorimi i kanaleve diplomatike nuk përjashtohet. Mjetet e tjera të komunikimit mund të merren vesh me marrëveshje të drejtpërdrejta të dy palëve ose të më shumë palëve.”

### KAPITULLI VI

#### Neni 6

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilët kanë

nënshkruar Konventën. Do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aprovimit do të depozitohen në Sekretariatin Gjeneral të Këshillit të Evropës.

2. Protokollin do të hyjë në fuqi 90 ditë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, miratimit, aprovimit.

3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që ratifikon, pranon ose aprovon më vonë, Protokollin do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit.

4. Një shtet anëtar i Këshillit të Evropës mund të mos ratifikojë, pranojë ose aprovojë këtë Protokoll, pa ratifikuar më parë Konventën.

#### Neni 7

1. Çdo shtet që ka pranuar Konventën, mund të pranojë këtë Protokoll pa hyrë ky Protokoll në fuqi.

2. Një pranim i tillë do të ketë efekt me depozitimin në Sekretariatin Gjeneral të Këshillit të Evropës të instrumentit të pranimit, i cili do të hyjë në fuqi 90 ditë pas depozitimit.

#### Neni 8

1. Çdo shtet mund, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, të specifikojë territorin ose territoret ku do të zbatohet ky Protokoll.

2. Çdo shtet mund, kur depoziton instrumentet e ratifikimit, pranimit, aprovimit hyrjes ose në një datë të mëvonshme, me deklaratën e drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, do të zgjerojë këtë Protokoll në territore të tjera të specifikuara në deklaratë dhe për të cilat marrëdhëniet ndërkombëtare janë përgjegjëse ose në emër të të cilëve është autorizuar të ndërmarrë detyrime.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas paragrafit të sipërcituar në lidhje me territorin e përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Një tërheqje e tillë do të ketë efekt 6 muaj pas marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

#### Neni 9

1. Rezervimet e bëra nga një shtet për parashikimet e Konventës duhet të jenë të zbatueshme për këtë Protokoll, me përjashtim të rastit kur shteti ka deklaruar ndryshe në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit, hyrjes.

2. Çdo shtet mund, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit, deklaron se rezervon të drejtën:

a) të mos pranojë kapitullin I;

b) të mos pranojë kapitullin II, ose ta pranojë atë vetëm për vepra penale të caktuara ose kategori të caktuara veprash penale që referohen në nenin 2;

c) të mos pranojë kapitullin III ose të pranojë vetëm paragrafin e parë të nenit 3;

d) të mos pranojë kapitullin IV;

e) të mos pranojë kapitullin V.

3. Çdo Palë kontraktuese mund të tërheqë rezervimet e bëra për paragrafët e mësipërm me anë të deklarimeve të adresuara Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, të cilat do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së tyre.

4. Një Palë kontraktuese që ka bërë një rezervim për këtë Protokoll, në lidhje me një parashikim të Konventës ose një rezervim për një parashikim të Protokollit, nuk mund të kërkojë zbatimin e këtyre parashikimeve nga një Palë tjetër kontraktuese; megjithatë, nëse rezervimet e tij janë të pjesshme ose kushtëzuese, aplikimi i këtyre dispozitave mund të kërkohet për aq sa janë pranuar nga vetë ata.

5. Nuk mund të bëhen rezervime të tjera për parashikimet e këtij Protokollit.

#### Neni 10

Komiteti Evropian për Problemet Penale i Këshillit të Evropës do të informohet në lidhje me zbatimin e këtij Protokollit, dhe do të bëjë çdo gjë të nevojshme të lehtësojë për një zgjidhje miqësore të çdo problemi që mund të dalë gjatë ekzekutimit.

#### Neni 11

1. Çdo Palë kontraktuese mundet për aq sa i intereson, të denoncojë këtë Protokoll me anë të njoftimit të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Një denoncim i tillë hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së njoftimit.

3. Denoncimi i Konventës do të thotë denoncim automatik i Protokollit.

#### Neni 12

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet Palë, për:

a) çdo nënshkrim të këtij Protokollit;

b) çdo depozitim të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes;

c) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokollit sipas nenit 6 dhe 7;

d) çdo deklaram i bërë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 2 dhe 3 të nenit 8;

e) çdo deklaram i marrë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 1 të nenit 9;

f) çdo rezervim i bërë sipas parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 9;

g) tërheqja e çdo rezervimi të bërë sipas parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 9;

h) çdo njoftim i marrë sipas parashikimeve të nenit 11 dhe datën në të cilën ka hyrë në fuqi denoncimi.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006

Çmimi 16 lekë